

UDHËZIM
Nr. 14, datë 3.8.2026

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 27, DATË 29.12.2017, TË MINISTRIT TË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË, “PËR STRUKTURAT E BRENDSHME AKADEMIKE DHE ADMINISTRATIVE NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 129, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Pika 17, e udhëzimit nr. 27, datë 29.12.2017, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë”, ndryshon si më poshtë:

“17. Strukturat e auditimit të brendshëm janë në varësi të Rektorit të institucionit publik të arsimit të lartë.”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT
Mirela Kumbaro Furxhi